

VENDIM
Nr.62, datë 26.1.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR RRËSHEN – KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen – Kalimash.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 10 472 761 (dhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 249 000 (dyqind e dyzet e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 472 761 (dhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.2.2011 dhe të përfundojë më 1.6.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe ai i regjistrimit pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, si dhe pasi ata të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

9. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ZVRPP-së”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të jetë dhënë konfirmimi i saktë lidhur me titullin e pronësisë nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, për objekt, si dhe pasi ata të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve do të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7, 8 e 9 të këtij vendimi.

11. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit. Kjo procedurë do të ndiqet jo vetëm për këtë vendim, por për të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë miratuar shpronësimin e pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen – Kalimash.

12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e

regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Mirditë, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA SEGMENTI RRUGOR
“RRËSHEN-REPS-THIRRË”

Nr.	Pronari			ZK	Nr.i pasurisë	Vlera lekë	Fshati	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	Dedë		Laska	3433	83/2	2285970	Shtrungaj	Konfirmuar nga ZVRP-ja
2	Frrok	Prend	Biba	3883	182,4	2420338	Zall-Xhuxh	Pas.4, në proces legalizimi/ Pas.182 Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Kujtim	Mark	Frroku	2162	107/8	1111031	Klos	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Zef	Ndue	Luka	2933	145/1	1408629	Pshqesh	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
5	Mark	Preng	Prenga	3259	106	3096130	Sang	Proces legalizimi
6	Gjet	Nikoll	Pershqefa	1190	60	150663	Bisak	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		TOTALI				10472761		